



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË**



**Përmbledhje**

**E MBLEDHJES SË NËNTË TË KOMITETIT KOMBËTAR TË SISTEMIT TË  
PAGESAVE (KKSP)**

*E mërkurë, datë 13 dhjetor 2023, nga ora 10:00 deri 13:45, pranë Bankës së Shqipërisë*

Në datën 13 dhjetor 2023, u zhvillua mbledhja e nëntë e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP). Mbledhja u drejtua nga Kryetarja e Komitetit, Zj. Luljeta Minxhozi, Zëvendësguvernatore e Parë e Bankës së Shqipërisë.

Përveç anëtarëve të Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave në mbledhje merrnin pjesë dhe Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë, Z. Endrit Yzeiraj, dhe përfaqësues nga Banka Botërore dhe Banka e Italisë.

Të ftuar në takim ishin gjithashtu përfaqësues nga bankat, institucionet financiare jo banka, operatorët e skemave kombëtare të pagesave me kartë, si dhe stafi i Bankës së Shqipërisë.

Aktiviteti u hap nga Zëvendësguvernatorja Zj. Minxhozi dhe Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë Z. Yzeiraj, të cilët theksuan rolin e rëndësishëm të Komitetit Kombëtar të Pagesave në zbatimin e reformave strategjike për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE).

Në fjalën e saj hyrëse, Kryetarja e KKSP Zj. Minxhozi falenderoi pjesëmarrësit për mbështetjen aktive në kuadër të përmbushjes së objektivave të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël (2018-2023) ku nga pikëpamja rregullative u arrit përafrimi i kuadrit tonë me atë të Bankës Qendrore Evropiane (BQE) për shërbimet e pagesave PSD2, ndërsa jemi në fazën e fundit të aprovimit të ligjit për llogarinë e pagesave për shërbime bazike, edhe ky i përafuar me direktivën e BE-së. Përmirësimi i kuadrit rregullativ është mbështetur dhe nga përmirësimi i infrastrukturave, si realizimin e debitimit direkt ndërbankar, ngritjen e sistemit për shlyerjen e pagesave në euro të klientëve dhe zgjerimi i pjesëmarrjes së institucioneve të pagesave dhe të parasë elektronike në

sistemin AECH. Zj. Minxhozi theksoi se përpjekjet e përbashkëta të komunitetit për sistemet dhe shërbimet e pagesave janë reflektuar në tejkalimin e synimeve të vendosura në Strategji.

Zëvendësgovernatorja Minxhozi u shpreh se Banka e Shqipërisë ka nisur punën për anëtarësimin e Shqipërisë në Tregun Unik të Pagesave, ose njohur ndryshe SEPA, që prej vitit 2021, kur u bëme pjesë e projektit rajonal "Për modernizimin e sistemeve të pagesave në vendet e Ballkanit Perëndimor". Pjesëmarrja e Shqipërisë në SEPA jo vetëm që do të shënojë një hap tejet të rëndësishëm në rrugëtimin e integritit evropian, por do të krijojë lehtësira për bizneset dhe konsumatorët shqiptarë në terma të kostos, kohës dhe thjeshtësisë me të cilën do të kryejnë transaksione ndërkufitare brenda tregut evropian. Gjithashtu ky projekt vlerësohet se do të ketë një kontribut domethënës në disa sektorë strategjikë siç është turizmi dhe eksportet me BE, ndërkohë që pritet të ndikojë dhe formalizimin e flukseve të remitancave.

Në fjalën e saj, Zj. Minxhozi u shpreh se në rolin e autoritetit monetar, rregullator e mbikëqyrës, Banka e Shqipërisë e vlerëson pozitivisht implementimin e një zgjidhjeje për "pagesat e shpejta" të cilat janë një mundësi alternative për pagesat elektronike, pasi sigurojnë pagesa përgjatë 24 orëve në çdo ditë të javës me kosto më të ulëta se instrumentet alternative. Në rastin e Shqipërisë, "pagesat e shpejta" vlerësohet se do të ndihmojnë edhe në zgjerimin e përdorimit të pagesave elektronike dhe zgjerimin e përfshirjes financiare të popullatës.

Për zbatimin e projektit për pagesat e shpejta (*instant payment*) po bashkëpunohet me Bankat Qendrore të Sistemit Evropian, si ajo e Italisë, por dhe Bankën Qendrore Evropiane. Implementimi me sukses i tij, eventualisht do të krijojë kushtet për integrimin tonë në sistemin evropian TIPS, por mund të shërbejë potencialisht si një zgjidhje dhe për vende të tjera të Ballkanit Perëndimor.

Në përfundim të fjalës së saj, Zj. Minxhozi bëri të ditur se Banka e Shqipërisë së shpejti do të miratojë strategjinë e saj për edukimin dhe përfshirjen financiare. Banka e Shqipërisë e ka renditur edukimin financiar ndër prioritetet e zhvillimit të vet afatmesëm, pasi gjykon se një publik i mirëinformuar financiarisht, kupton më mirë vendimet e institucioneve financiare dhe rrjedhimisht forcon besimin tek to. Edukimi financiar është thelbësor për marrjen e vendimeve të informuara dhe kontrollin e rreziqeve për çdo individ, veçanërisht me shtimin e kompleksitetit të shërbimeve financiare dhe risitë teknologjike. Ajo ftoi të gjithë pjesëmarrësit të jenë aktiv në drejtim të përpjekjeve për të rritur mirëqenien financiare të shqiptarëve.

Më tej e mori fjalën Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë, Z. Yzeiraj, i cili përshëndeti realizimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Pagesat e Vogla, të cilat kanë ndihmuar në zgjerimin e përfshirjes financiare të popullsisë dhe në reduktimin e përdorimit të parasë fizike. Ai shprehu mbështetjen e Ministrisë për projektet e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për të ndryshimet rregullatore që kërkohen në kuadër të anëtarësimin në SEPA, një objektiv i rëndësishëm ky i qeverisë shqiptare në axhendën politike të integritit evropian. Gjithashtu, Z. Yzeiraj vlerësoi gjetjen e një zgjidhjeje për pagesat e shpejta, si një instrument i cili do të mundësojë zhvillimin e projekteve të tjera të ndërlidhura të qeverisë, si ai mbi zhvillimin e tregtisë elektronike, dixhitalizimit të plotë të fiskalizimit dhe dixhitalizimit të shërbimeve në e-Albania.

Pas fjalimeve përshëndetëse, mbledhja vijoi me diskutime në nivel teknik.

**Në panelin e parë**, diskutimet u fokusuan masat e marra deri tani në kuadër të projektit rajonal “Modernizimi i sistemit të pagesave në Ballkanin Perëndimor” i cili u prezantua nga Drejtoresha e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Zj. Ledia Bregu. Në prezantimin e saj, Zj. Bregu evidentoi arritjen e objektivave të vendosura në Strategjinë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël (2018-2023), si në terma të përmirësimeve rregullatore, ashtu edhe në terma të infrastrukturave të reja. Objektivat e matshëm (sasiorë) të Strategjisë janë arritur ose tejkaluar. Tashmë pothuajse 69.88% e popullsisë së rritur zotëron një llogari, nga 70% që është objektivi, dhe përdorimi i pagesave elektronike për frymë është 17.9 pagesa, duke tejkaluar objektivin e synuar prej 10 pagesash deri në fund të vitit 2023. Zj. Bregu vijoi prezantimin e saj me masat e ndërmarra për Projektin Rajonal të Ballkanit Perëndimor si dhe shtyllat kryesore për realizimin me sukses të tij.

Prioritet në këtë projekt janë përgatitja e Shqipërisë për një anëtarësim të përshpejtuar në Tregun Unik të Pagesave në Euro (SEPA), ku kriteret për zgjerimin e shtrirjes gjeografike të Zonës Unike të Pagesave në Euro (SEPA) janë përcaktuar nga Këshilli Evropian i Pagesave (EPC) dhe vlerësimi i përputhshmërisë me kriteret e pjesëmarrjes në SEPA ndërmerren po nga i njëjti entitet. Pas diskutimeve dhe analizës me Bankën Botërore vlerësohet se Shqipëria është ndjeshëm e avancuar në përafrimin e legjislacionit, i cili përbën kriter për pranimin në SEPA. Gjithashtu Banka e Shqipërisë ka intensifikuar përpjekjet së bashku me Bankën Botërore dhe Bankën Qendrore të Italisë për krijimin e sistemit *Instant Payment* në Shqipëri. Zj. Ledia Bregu prezantoi edhe një nismë të fundit që synon të promovojë pagesat elektronike, standartin vendas të QR Code, i cili synon të mbështesë zhvillimet e ardhshme në axhendën dixhitale si dhe të lehtësojë ndërveprimin e pagesave brenda vendit si dhe me rajonin dhe BE-në. Zj. Bregu e mbylli prezantimin duke theksuar katër prioritetet kryesore të punës së Bankës së Shqipërisë në fushën e sistemeve të pagesave në afatin e mesëm: *SEPA, Instant Payment, Upgrade* i Sistemeve të Pagesave që operon BSh dhe Edukimi Financiar.

Prezantimet vijuan me përfaqësuesin e Bankës së Italisë Z. Giuseppe Bruni, i cili i njohu të pranishmit me propozimin e Bankës së Italisë për krijimin e sistemit për pagesat e shpejta në Shqipëri. Ky sistem do të jetë një kopje e sistemit TIPS që operon Eurosistemi për pagesa të shpejta. Ndonëse me kapacitet procesimi më të vogël, sistemi klon i propozuar do të ketë të njëjta funksionalitete dhe ndërfaqe me atë TIPS, duke bërë të mundur që në ardhmen, sistemi lokal të integrohet lehtësisht me sistemin TIPS. Rregullat dhe protokollat që do të ndjekë sistemi lokal për pagesat e shpejta do të jenë të njëjta me atë të TIPS. Avantazhet kryesore të adoptimit të sistemit nëpërmjet Bankës së Italisë qëndrojnë tek kostot e implementimit dhe know-how. Banka e Shqipërisë do të jetë në rolin e operatorit të biznesit, ndërsa do të përfitojë nga mbështetja teknike e Bankës së Italisë. I gjithë komuniteti përkatës do të instruktohet për përdorimin e sistemit, duke qenë të përgatitur për përdorimin e sistemit të Eurosistemit në të ardhmen.

Z. Matija Laco, përfaqësues i Bankës Botërore prezantoi mbi avantazhet e pjesëmarrjes në SEPA, kriteret e anëtarësimit në SEPA dhe përmbushjen e kushteve nga Shqipëria. Pjesëmarrja në SEPA pritet të rrisë eficiencën e kryerjes së pagesave, lehtësinë për ekzekutimin e tyre dhe reduktimin e

kostove. Anëtarësimi në SEPA kërkon përafrime të kuadrit rregullator, aspekt në të cilin Shqipëria ka një nivel të kënaqshëm plotësimi. Një pjesë e mirë e kuadrit rregullator është e përafër, ndërsa mbetet ende një pjesë për tu realizuar në vijim. Z. Laco theksoi se zbatimi i një infrastrukture për pagesat e shpejta përforcon avantazhet që mund të merren nga anëtarësimi në SEPA, ndaj projekti i pagesave të shpejta duhet të realizohet paralelisht. Banka Botërore do të asistojë të gjithë procesin e anëtarësimit për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

**Paneli i dytë** u fokusua në zhvillimet me të fundit infrastrukturore në tregun vendas – *Open-Banking* dhe Up-grade i sistemeve të pagesave AIPS, AIPS EURO dhe AECH.

Z. Deniz Deralla, drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes prezantoi ecurinë e procesit të përditësimit të sistemeve të bankave për t'u përgjigjur kërkesave të rregullores, "Për autentifikimin e thëlluar të klientit dhe standardet e përbashkëta, të hapura dhe të sigurta të komunikimit" e cila është miratuar në qershor të vitit 2022, dhe hyn në fuqi në janar të vitit 2024. Çështje me interes të veçantë është rregullimi i komunikimit për APIs - Application Program Interfaces dhe konceptin e bankës së hapur (*open banking*) dhe mbi autentifikimin e thëlluar të klientit, elemente këto që plotësojnë të gjithë kuadrin e nevojshëm për promovimin e inovacionit në treg. Gjithashtu në fjalën e tij, Z. Deralla përcaktoi se objekte të kësaj rregulloreje, përveç bankave, do të jenë dhe Institucionet e Pagesave dhe Institucionet e Parasë Elektronike. Këto pritet të aplikojnë për tu regjistruar pranë Bankës së Shqipërisë, pasi Ligji "Për shërbimet e pagesave" lejon konceptin e ofruesit të shërbimit të inicimit të pagesës dhe ofruesit të shërbimit të informimit të llogarisë, si palë të rëndësishme në Open Banking.

Përveç përfitimeve dhe disavantazheve nga implementimi i API dhe *open-banking*, Z. Deralla përmendi dhe zgjidhjet e mundshme që mund të ofrohen bankave dhe Jo bankave në lidhje me sigurinë e të dhënave pasi rregullorja iu lejon ofruesve të shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë që i ofrojnë një paguesi një llogari pagese të aksesueshme *online*, mundësinë e zgjedhjes midis: i) një ndërfaqeje të dedikuar për komunikimin me ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë, ofruesit e shërbimit të inicimit të pagesës dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave që emetojnë instrumente pagese të bazuara në karta; ose përdorimit nga ofruesit e mësipërm të shërbimeve të pagesave, të ndërfaqeve të përdorura për autentifikimin dhe komunikimin me përdoruesit e shërbimeve të pagesave të ofruesve të shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë. Në çdo rast, ndërfaqet duhet të ndjekin standardet e komunikimit të aplikueshme në Bashkimin Evropian.

Z. Deralla tha se bankat kanë marrë masa për plotësimin e kërkesave të rregullores; ato kanë përzgjedhur ofruesit për të mundësuar *Open Banking*; disa i kanë përditësuar sistemet e tyre, ndërsa disa janë në fazë përditësimi, dhe disa banka i kanë testuar ato. Megjithatë, bankat kanë hasur disa problematika për implementimin e *open banking* të cilat janë duke i adresuar. Pak banka janë të gatshme të dalin *live* në zbatim të rregullores në 1 janar të vitit 2024.

Z. Deralla e mbylli prezantimin e tij duke inkurajuar bankat të përfundojnë sa më parë përditësimet e nevojshme në sistemet e tyre informatike, si dhe të përdorin maksimalisht harkun kohor deri në periudhën 6-mujore në ambientet *sandbox* dhe testimet e nevojshme të sistemit për të mundësuar

dalje *online* në fund të periudhës. Ndërkohë, ato duhet të marrin masa të pajisen me certifikatat e kualifikuara për vulat elektronike, për një implementim të plotë të kërkesave të rregullores 29/2022. Ai i ftoi institucionet e pagesave dhe të parasë elektronike për të ofruar shërbimin e inicimit të pagesës (shërbimi nr.7) dhe/ose shërbimin e informimit të llogarisë (shërbimi nr.8), me qëllim vënien në funksionim të *Open-Banking*.

Diskutimet e këtij paneli përfunduan me prezantimin "Për zhvillimet infrastrukturore për *up-grade* të sistemeve AIPS, AIPS Euro dhe AECH në standardin e komunikimit ndërkombëtar ISO 20022", si dhe me krijimin e faciliteteve të tjera të cilat mbështesin objektivat e Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël, i prezantuar nga Zj. Valentina Semi, Zëvendësdrejtoreshë pranë Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës.

Zj. Semi theksoi se një nga objektivat kryesore të projektit, përveç përmirësimit të infrastrukturës teknike për Sistemet e Pagesave me qëllim rritjen e sigurisë dhe efikasitetit, është implementimi i standardeve të procesimit të mesazheve (SEPA/ISO 20022), i cili do të akomodojë dhe shumë nga zhvillimet e nevojshme strategjike të BSH. Risitë që sjell ky *up-grade* i sistemeve AIPS dhe AECH, do të përmirësojnë administrimin e rezervës së detyrueshme pasi do aplikohet një mekanizëm më fleksibël administrimi dhe periudhë variabël e mbajtjes së saj, diferencime në përcaktimin e normave të interesit, normës së rezervës dhe penalteteve sipas pjesëmarrësve. Një fleksibilitet i tillë ndihmon në zgjerimin e gamës së instrumenteve për zbatimin e politikës monetare. *Upgrade* i sistemit AIPS do realizojë implementimin e funksionalitetit për përlllogaritjen e remunerimit të fondeve për llogaritë e shlyerjes.

Përsa i përket *upgrade* të sistemit AECH, Zj. Semi tha se sistemi AECH do të ketë të implementuar dhe do të jetë në përputhshmëri me standardin ISO 20022 XML, si dhe në përputhshmëri me bashkësinë e rregullave SEPA për Transfertat e Kreditit dhe Debitimet Direkte. Gjithashtu, pas *upgrade* te sistemit AECH, me mjaft rëndësi është ofrimi nga sistemi i funksionaliteteve për administrimin e procesit të klerimit dhe shlyerjes së transaksioneve për pjesëmarrësit indirekt, si dhe mitigimi i rrezikut të likuiditetit nëpërmjet mekanizmit automatik "*rewind*".

Në fund të prezantimit, Zj. Semi përmendi rëndësinë e këtij projekti për realizimin dhe implementimin e projektit *Instant payment*, pjesëmarrjen në SEPA, dhe materializimin e Strategjisë së Pagesave me Vlerë të Vogël. Ajo kërkoi ngritjen e një grupi pune ndërbankar për të bashkëpunuar dhe komunikuar në mënyrë të vazhdueshme deri në realizimin e testeve dhe kalimin *live* sipas afateve të përcaktuara.

**Paneli i fundit** i mbledhjes iu dedikua Edukimit Financiar. Në këtë kuadër u mbajt një prezantim nga Z. Altin Tanku, Drejtor i Departamentit të Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë, i cili prezantoi Strategjinë e Bankës së Shqipërisë për edukimin dhe përfshirjen financiare.

Z. Tanku citoi se kjo Strategji vjen si një domosdoshmëri për të rritur më tej kulturën financiare dhe përdorimin e shërbimeve financiare të rregulluara në kushtet e sofistikimit të sektorit financiar dhe të rreziqeve të reja për konsumatorin. Edukimi financiar mund të adresojë barrierat e kërkesës, të tilla si mungesa e besimit në sistemin financiar dhe me rritjen e besimit në sektorin financiar,

individët familjarizohen me produktet dhe mundësitë e ndryshme, si dhe fillojnë t'i aksesojnë dhe t'i përdorin ato. Strategjia është hartuar duke u mbështetur në rezultatet e Vrojtimit të katërt për Matjen e Kulturës dhe Përfshirjes Financiare. Rezultatet e vrojtimit të ardhshme do të shërbejnë për të matur dhe monitoruar impaktin e aktiviteteve edukuese në periudhën e referencës dhe për të orientuar strategjinë në të ardhmen.

Mbledhja e nënte e Komitetit të Pagesave u mbyll me **konkluzionet dhe rekomandimet** e Kryetares së Komitetit, Zj. Luljeta Minxhozi.

Zj. Minxhozi theksoi me prioritet intensifikimin e përpjekjeve të të gjithë komunitetit bankar dhe të aktorëve të sistemit financiar për edukimin e publikut të gjerë me njohuri të kulturës financiare. Ky edukim duhet të fillojë që në komunikimet me klientët bankarë dhe të shtrihet edhe tek shtresa që nuk kanë qasje në shërbimet bankare apo financiare në përgjithësi. Hapat e shpejtë me të cilat po ecet në fushën e shërbimeve të pagesave duhet të shkojnë paralelisht me edukimin e publikut. Zhvillimet në fushën e pagesave synojnë të rrisin, krahas eficiencës, edhe thjeshtësinë e kryerjes së pagesave dhe aksesin në shërbimet e pagesave, gjë që duhet të reklamohet tek publiku i gjerë.

Projektet e iniciuara për anëtarësimin e Shqipërisë në SEPA dhe për implementimin e *instant payment* janë gurë kilometrik në historikun e zhvillimeve në fushën e pagesave ndaj kërkohet angazhimi serioz, bashkëpunimi dhe mbështetja nga i gjithë komuniteti i përfaqësuar në Komitet për realizimin në kohë të tyre. Banka e Shqipërisë do të komunikojë vazhdimisht mbi ecurinë e këtyre projekteve, si dhe mbi përgjegjësitë përkatëse. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë do të kërkojë ngritjen e grupit të punës mbi *upgrade* të sistemeve AIPS, AIPS – EURO dhe AECH.

## Pjesëmarrja në mbledhje

Mbledhja e nëntë e KKSP			
Institucioni	Emri i anëtarit	Statusi në KKSP	Përfaqësues të tjerë të institucionit
<b>Banka e Shqipërisë</b>	Znj. Luljeta Minxhozi, Zëvendësguvernatore e Parë	Kryetare	Z. Altin Tanku Zj. Jonida Kacani Zj. Elona Dushku Zj. Xhilda Kanini Zj. Dorianë Lama Zj. Amela Mehmeti Zj. Evis Çeli Zj. Edlira Hoxha Zj. Armida Isakaj Zj. Arlinda Kolenico Z. Gerti Myrselaj
	Zj. Ledia Bregu, Drejtor i Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës	Zëvendëskryetar	
	Z. Deniz Deralla, Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes	Anëtar	
	Zj. Valentina Semi, Zv. Drejtor i Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës	Anëtar	
<b>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</b>	Z. Endrit Yzeiraj Zëvendësministër	Anëtar	
<b>Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)</b>	Zj. Flora Musta	Anëtar	
<b>Shoqata e Bankave</b>	Z. Spiro Brumbulli	Sekretariat	Zj. Eftali Peci
<b>ALREG</b>	Zj. Silva Serjani	Anëtar	
<b>Paylink</b>	Zj. Eneida Thomaj, Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	
<b>Unioni Financiar Tiranë</b>	Z. Elton Çollaku, Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	Zj. Eriona Miraka Z. Dalip Bali
<b>Easy Pay</b>	Zj. Linda Shomo Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	
<b>MPay</b>	Zj. Bora Ferri	Anëtar	
<b>Rubicon</b>	Z. Gentian Dekovi	Anëtar	
<b>OTP Bank Albania</b>	Zj. Irida Huta	Anëtar	Zj. Ada Naqe
<b>NOA</b>	Z. Ervin Gogaj	Anëtar	
<b>RPAY</b>	Zj. Noel Shehu	Anëtar	
<b>Tirana Bank</b>	Zj. Najada Xhaxha	Anëtar	Zj. Eni Nesturi
<b>UBA Bank</b>	Zj. Alma Beja	Anëtar	Z. Ermal Hushta
<b>Raiffaisen Bank</b>	Z. Resmi Hibraj	Anëtar	Zj. Gentiana Gjino
<b>Procredit</b>	Zj. Elena Jaku	Anëtar	Zj. Uarda Dosti
<b>Intesa San Paolo</b>	Zj. Xhilda Shehu	Anëtar	Zj. Luci Shiroka

<b>FIB bank</b>	Zj. Ines Vucini	Anëtar	Zj. Elona Labinoti
<b>Credins Bank</b>	Z. Dimitri Toslluku	Anëtar	Zj. Suela Cela
<b>Union Bank</b>	ZJ. Fatbardha Rino	Anëtar	Zj. Valbona Cucka
<b>ABI Bank</b>	Zj. Odeta Paloka	Anëtar	Zj. Edlira Madhi Zj. Majlinda Miho
<b>Ak –Invest</b>	Z. Blend Pustina	Anëtar	
<b>e-Reja</b>	Z. Geis Ceku	Anëtar	
<b>FED invest</b>	Zj. Liliana Nanaj	Anëtar	
<b>IUTEPAY</b>	Zj. Stela Shkodrani	Anëtar	
<b>E-PARA</b>	Zj. Gentiana Gjonça	Anëtar	
<b>AMA</b>	Z. Junid Tafaj	Anëtar	
<b>Banka Botërore</b>	Zj. Edlira Dashi	Anëtar	
<b>Posta Shqiptare</b>	Zj. Nevila Bejler	Anëtar	